



Duket se nuk do të jete edhe aq i thjeshtë rinovimi i Xhani De Biazit me Shqipëri. Pas kthimit nga dy ndeshjet e humbura në Slloveni dhe Islande, kontrata e italianit me kuqezinjte ende nuk është firmosur. Armand Duka ka deklaruar se De Biazi e ka dërguar të hapur ndërsa vetë trajneri ka thënë se ja ka lënë në dorë presidentit. As njëri dhe as tjetri nuk kanë hedhur hapin e parë. Duket se kjo periudhë do të jete një fazë ku të dy do të testojnë nervat përpara se të vendosin për të ulur dhe vendosur përfundimisht për rinovimin. Tifozet kuqëzi bëjnë presion që De Biazi të mos largohet por në fund do të jete presidenti i FSHF-se ai që do të vendosi.